



ЦЕНТАР ЗА РАЗВОЈ НА ЈУГОЗАПАДНИОТ ПЛАНСКИ РЕГИОН  
CENTRE FOR DEVELOPMENT OF THE SOUTHWEST PLANNING REGION



Министерство за локална самоуправа  
Ministria e vetëqeverisjes lokale  
Ministry of Local Self - Government



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC

Të nderuar,

Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor fillon me realizimin e projektit “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv”, i cili përfshin edhe organizimin e Forumeve rajonale në bashkësi, me qëllim që të përforcohet pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal dhe rajonal, të përmirësohen partneritetet mes subjekteve rajonale dhe lokale dhe të gjenden zgjidhje më efikase për problemet me interes për të gjithë rajonin.

Projekti është i përkrahur nga Qeveria e konfederatës Zvicerane përmes Ambasadës së Zvicrës në Republikën e Maqedonisë/Agjencia zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC) dhe Ministrisë së vetëqeverisjes lokale, dhe do ta implementojë Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor në bashkëpunim me komunat dhe palët e tjera të prekura nga rajoni.

Forumet rajonale përfshijnë 4 (katër) sesione, nga të cilat 3 (tre) do të realizohen në muajin shkurt dhe në to do të elaborohen problemet më prioritare të bashkësisë në sferat tematike në vijim: **Infrastruktura turistike, Mbrojtja e ambientit jetësor, Infrastruktura e biznesit dhe Inkluzioni social**. Pastaj do të vijojë procesi i zhvillimit të projekt ideve dhe ofrimit të zgjidhjeve të mundëshme, në bazë të cilës do të përgatiten pesë koncepte projektuese, nga të cilat tre projekt koncepte që janë më lartë të ranguara nga forumet rajonale për aplikim, do të aprovohen në seancën e Këshillit për zhvillim të rajonit planor JUGPERËNDIMOR. Për realizimin e projektit të përzgjedhur nga ana e Komisionit për evaluim, mund të fitohen 112.000 franga zvicerane. Projekti duhet të jetë në një nga sferat tematike të lartpërmendura, duhet të përmbajë komponentë infrastrukturore, dhe i njëjti duhet të realizohet deri në fillim të këtij viti.

Me qëllim të zbatimit me sukses të gjithë procesit, Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor ju fton të merrni pjesë aktive në sesionin e parë të forumit, e cila do të mbahet në datë 13.02.2019 (e mërkurë), në Hotel Drim-Strugë, me fillim në ora 11.00.

**Ju lutemi pjesëmarrjen Tuaj ta konfirmoni përmes postës elektronike në adresën vijuese: [a.vlashi@southwestregion.mk](mailto:a.vlashi@southwestregion.mk), ose në telefonin celular: 072 316 882 deri në datë 11.02.2019.**

Me respekt,

Qendra për zhvillim të rajonit  
planor JUGPERËNDIMOR

Udhëheqës,  
M-r Mirjana Lozanoska

Strugë, 06/02/2019

## AGJENDA

Projekti “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv”  
Sesioni i parë në kuadër të programit “Forumet rajonale në bashkësi” në rajonin planor

Jugperëndimor

Moderator: Sara Osmani

Hotel Drim, salla Piano, Strugë

Data 13.02.2019

11.00 – 11.15	Ardhja dhe regjistrimi i pjesëmarrësve
11.15 – 11.30	Fjalë përshëndetëse <ul style="list-style-type: none"> <li>• Agjencia Zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim</li> <li>• Ministria e vetëqeverisjes lokale</li> <li>• Përfaqësues i rajonit planor Jugperëndimor</li> </ul>
11.30 – 11.45	Strukturimi i forumit/shpërndarja në tavolinat e punës Përcaktimi i rregullave për punë
11.45 – 12.15	Prezantimi i procesit të forumit Kriteret për përzgjedhjen e projekteve
12.15 – 13.15	Identifikimi dhe përcaktimi i problemeve Diskutimi në tavolinat e punës dhe prezantim Grupimi i problemeve
13.15 – 14.15	Propozimi i zgjidhjeve Diskutim sipas tavolinave të punës dhe prezantim Formimi i grupeve të punës për propozim zgjidhjet
14.15 - 14.30	Vlerësimi i sesioneve të forumeve Marrëveshje për sesionin e ardhshëm
14.30	Koktel